

I – ORIGJINA DHE EVOLUIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

1. Terminologjia

Shprehjet “të drejtat e njeriut”, “të drejtat njerëzore”, “të drejtat e personit” janë përdorur në mënyre alternative për t’iu referuar të njëjtit koncept. Më përpara përdoreshin më shpesh shprehjet “të drejta natyrore” dhe “të drejta origjinare”. Gjithashtu, edhe shprehja “të drejta morale”, e përdorur nga Stuart Mill, bën pjesë në filozofinë juridike të këtyre të drejtave. Më vonë, pasi të drejtat e njeriut filluan të inkorporoheshin brenda deklaratave të para kombëtare dhe ndërkombëtare apo dhe në kartat kushtetuese kombëtare, u fillua të flitej dhe për “të drejta themelore” apo “liri themelore”. Duke analizuar terminologjinë e përdorur nga shekulli XVIII deri më sot – të drejtat e njeriut – arrihet në përfundimin se koncepti “njeri” i referohet qenies njerëzore në mënyrën më të gjërë të mundshme, edhe pse duhet nënvizuar që hera herës termi është përdorur për t’iu referuar vetëm disa kategorive të qenieve njerëzore (shtetasve, grave, fëmijëve, punëtorëve, të huajve, refugjatëve etj).

2. Nocioni i të drejtave të njeriut në evoluimin historiko-juridik

Në teoritë filozofike, shprehjeve të ndryshme i referohen koncepte të ndryshme. Kështu mund të bëjmë dallim midis konceptimit pozitivist dhe atij jusnatyralist.

Për jusnatyralizëm nënkuptohet ajo rrymë e mendimit juridik që ka këto dy karakteristika: 1) egziston qoftë e drejta natyrore qoftë e drejta pozitive; 2) e drejta natyrore është superiore ndaj të drejtës pozitive. Për pozitivizëm juridik nënkuptohet ajo rrymë e mendimit që nuk pranon egzistencën e të drejtës natyrore pranë asaj pozitive dhe mban qëndrimin që nuk egziston e drejtë tjetër përveçse asaj pozitive. Domethënë, ndërsa jusnatyralizmi afirmon egzistencën e të dy të drejtave, bashkë me hierarkinë midis tyre, pozitivizmi afirmon eksklusivitetin e të drejtës pozitive. Jusnatyralizmi është i tipit dual, ndërsa pozitivizmi i tipit monist.

Termi i përdorur nga pozitivistët është ai i të drejtave themelore. Ky term e ka filluesën në shekullin e XVIII, në kuadër të ngjarjeve politike që çuan në Deklaratën e të drejtave të qytetarit të 1789, që përfaqëson pozitivizimin për herë të parë të të drejtave të njeriut në kontinentin evropian. Ky fakt evidenton lidhjen e drejtpërdrejtë që egziston midis shprehjes “të drejta themelore” dhe legalizimit dhe njohjes të këtyre të drejtave në tekstet juridike kombëtare. Për juristët pozitivistë, të drejtat themelore janë të drejta që njihen si të tilla në një sistem juridik të caktuar: duke qenë se, në një vend të caktuar, të vetmet burime të së drejtës janë ligjet në fuqi, të cilat përcaktojnë të drejtat e njeriut dhe cilat prej tyre janë të drejta themelore. Në të kundërt, sipas jus natyralisteve, origjina e të drejtave të njeriut nuk gjendet në ligjet pozitive por në natyrën e njeriut si i tillë.

Sidoqoftë, në të dy modelet, titullari i të drejtave është personi njerëzor edhe pse mund të bëjmë një dallim midis një nocioni individualist, që i njeh domethënë individit, titullaritetin e ushtrimit të të drejtave, dhe nocionit kolektivist, që këtë titullaritet ia njeh individit vetëm kur ky ben pjesë në një grup të caktuar që është titullar i po këtyre të drejtave. Në lidhje me të drejtat, titullariteti i të cilave

është kolektiv, mund të kujtojmë psh që në shekullin e kaluar mbroheshin të drejtat e klasave të punëtorëve, të drejtat e njerëzve me ngjyrë, të drejtat e grave, të fëmijëve, dhe të minoriteteve.

Për sa i përket subjektit pasiv të këtyre të drejtave, domethënë të detyruarit kryesor për ti garantuar, ai është natyrisht Shteti si titullar i pushteti dhe garantues i rendit juridik. Ky funksion manifestohet nëpërmjet formave të ndryshme: funksionit legjislativ që ka për qëllim krijimin e normave që njohin dhe mbrojnë të drejtat e njeriut; funksionit gjyqsor që realizon të drejtën në të gjitha fushat e jetës sociale, duke qenë se aktiviteti i tij i drejtohet qoftë qytetarëve qoftë administratës publike. Kohët e fundit flitet edhe për një funksion tjetër, atë promovues, që filloi të zhvillohej paralelisht me afirmimin e të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore. Duhet theksuar se dhe individ i është subjekt pasiv i të drejtave të njeriut sepse duhet të bashkëpunojë me qëllim që të drejtat e njeriut të realizohen dhe te individët e tjerë. Në këtë kontekst u zhvillua dhe parimi i solidaritetit si shprehje e karakterit social dhe komunitar i personit njerëzor.

Për doktrinën pozitiviste, pozitivizimi ka funksion krijues dhe themelues të të drejtave të njeriut, nëpërmjet të cilit ata marrin vlerë themelore. Për doktrinën jusnatyraliste, pozitivizimi i të drejtës është përfundimi i një procesi logjik por pozitivizimi nuk ndikon as natyrën e as esencën e të drejtave. Pozitivizimi supozon njohjen e të drejtave të njeriut nga legjislatori dhe është kusht i domosdoshëm për ushtrimin e lirë të të drejtave.

Rindërtimi konceptual i të drejtave të njeriut është elaboruar fillimisht në kuadër të doktrinave filozofike për të kaluar më vonë edhe në kuadër të shkencave juridike. Të drejtat e njeriut gjejnë origjinën e tyre në esencën e individit, në natyrën e tij njerëzore, domethënë i përkasin sferës të së drejtës natyrore. Nën këtë profil, individ i lirë, në një situatë abstrakte, do të kishte fuqi të pakufizuar por normalisht kur individ i është i detyruar të bashkëegzistojë me të tjerë individë të kontekstit social, atëherë lind nevoja për të hequr dorë nga disa “fuqi” apo për ti kufizuar ato. Jo rastesisht te Deklarata për të drejtat e qytetarit të 1789 thuhet: *Ushtrimi i të drejtave natyrore të secilit njeri nuk ka kufij, përveç atyre të cilat u sigurojnë anëtarëve të tjerë të shoqërisëgëzimin e të njëjtave të drejta (l'exercice des droits naturels de chaque homme n'a des bornes que celles qui assurent aux autres membres de la société la jouissance de ces mêmes droits)*. E thënë më thjeshtë, është i nevojshëm një kufizim reciprok i fuqive/të drejtave të secilit me qëllim që çdo individ të ketë mundësi të ushtrojë po të njëjtat fuqi/të drejta.

Sipas këtij argumentimi njeriu, në gjendje natyrore si njeri i lirë, do të kishte fuqi dhe liri të pakufizuara, por që do të ishin të pasigurta sepse nuk egziston një sistem që i garanton. Për këtë arsye në shoqëritë e organizuara individ i heq dorë nga disa të drejta dhe liri abstrakte me qëllim që të gëzojë disa të drejta dhe liri të garantuara realisht. Domethënë bëhet kalimi nga të drejtat abstrakte që do të gëzoheshin në gjendjen natyrore në të drejtat konkrete që realizohen dhe mbrohen në një shoqëri të organizuar.

3. Të drejtat e njeriut në evoluimin e teksteve kombëtare dhe ndërkombëtare

Nëse duam të bëjmë një studim historik mbi të drejtat e njeriut për të parë nëse teoria dhe realiteti korrespondojnë, mjafton të shfletojmë studimet e shumta që janë bërë në këtë fushë. Kështu mund të

vërejmë që në fazën prehistorike të së drejtës mbrohej një e drejtë elementare e njeriut në gjendje natyrore: e drejta e jetës, e cila mbrohej duke parashikuar denime për ata që e shkelnin. Psh, kodi i Hamurabit i 1750 pes, ligjet e Athinës ne 700 pes, Ligjet Numa dhe Silla në Romë etj. Gjithashtu mund të thuhet edhe për mbrojtjen e integritetit fizik, edhe pse barazia dhe mosdiskriminimi janë koncepte që vetëm kohët e fundit kanë filluar të jenë të pranishëm në pothuajse të gjitha regjimet. Në fakt, në shoqëritë antike pranohej diferenca midis njerëzve të lirë dhe skllëvërve, midis qytetarëve dhe të huajve, ata që kishin dhe ata që nuk kishin të drejta etj.

Në fazën e dytë, atë gjatë periudhës mesjetare, fillon tu hapet rrugë të drejtave me natyrë kontratuale midis sovranit dhe individëve që ishin nën drejtimin e tij. Tashmë, përveçse të drejtës së jetës (që theksoj garantohej vetëm duke dënuar ata që kryenin vrasje, pra nuk ka kuptimin që merr sot) dhe integritetit fizik, u fillua të flitej dhe për lirinë e qarkullimit, lirinë personale, të pronës etj, dhe në disa raste keta të drejta shoqëroheshin dhe me një fare mbrojtje juridike për të evituar abuzime nga ana e sovranit.

Në fazën e tretë, atë të monarkive absolute, pati një kthim pas, një përkeqësim të të drejtave të fituara gjatë periudhave të mëparshme. Në këtë lloj forme të organizimit social, pushteti shkel dhe shtyp të drejtat dhe liritë e individit. Gjatë kësaj faze filloi zhvillimi i teorive filozofike të të drejtës natyrore si themel i procesit të kërkimit/rivendikimit të të drejtave të njeriut.

Afirmimi i të drejtave fillon në Angli me të famshmen *Magna Carta Libertatum* të 1215 e cila njeh disa të drejta dhe liri themelore të individit. Ky dokument u shpall nga mbreti Johani pa tokë (quhej kështu sepse, duke qenë vellai më i vogël ngeli pa tituj dhe prona) dhe konsiderohet si teksti i parë kushtetues i Anglisë dhe si themel i të drejtave dhe lirive që egzistojnë në këtë vend. Me shumë mundësi ai është teksti i parë në botë që përmban masa mbrojtjeje të sakta të lirisë personale: Asnjë njeri i lirë nuk do të arrestohet, burgoset, ti hiqën pronat, të dëbohet, apo të deklarohet si i jashtëligjshëm pa një gjykim legjitim të të barabartëve të tij në bazë të ligjeve të vendit.

Një shembull i ngjashëm është dhe *Il privilegio generale d'Aragona* që mbreti Pedro III i dha Oborrit të Zaragozës ne 1283.

Rreth tre shekuj më vonë, në 1598 u shpall dhe *Edikti i Nantës*, që kishte si qëllim kthimin e paqes në Francë dhe mbrojtjen e protestantëve. Ky edikt u tërhoq në 1685 nga Luigji i XIV.

Rëndësi të veçantë merr dhe *Petition of Rights* i 1628 i shpallur nga Charles I i Anglisë. Ky tekst shpallte disa parime si respekti i lirisë personale, ndalimi i vendosjes së taksava pa konsensusin e parlamentit, ndalimi i arrestimeve abuzive, e drejta e mbrojtjes etj. Ky dokument u shfuqizua nga mbreti Charles pak vite më vonë.

Parlamenti anglez, për të evituar një konflikt të ri me mbretin e ardhshëm Gulielm d'Orange, e detyroi atë të firmoste në 1689 *The Bill of Rights* perpara se ai të merrte fronin. Ky dokument cilësohet si esencial për historinë britanike. Ky tekst përmban një seri artikujsh konform shtetit të së drejtës, gjë që vihet re që në dispozitën e parë, e cila specifikon që edhe mbreti i nënshtrohet ligjit. Gjithashtu përmban disa të drejta si ajo e votës, liria individuale dhe garancitë qyjësore të afirmuara në *Magna Charta* dhe *Habeas corpus*. Kjo e fundit u adoptua në 1679 dhe është një rregull procedural që kërkon praninë fizike të të akuzuarit gjatë procesit. Ajo garanton individët kundër arrestimeve dhe dënimeve arbitrare.

Sidoqoftë, aktet që i referohen specifikisht të drejtave të njeriut, përfaqësohen nga Deklaratat e adoptuara në fund të shekullit të XVIII, të parat nga të cilat janë “*Deklarata e të drejtave të popullit të mirë të Virxhinias*” e 12 qershor 1776 dhe *Deklarata e Pavarësisë amerikane* e 4 korrik 1776. Në të dy këto deklarata, të tipit jusnatyralist, afirmohet se: *të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe të pajisur nga Krijuesi me të drejta të patjetërsueshme prej të cilave rrjedhin liria dhe kërkimi i lumturisë.*

Në Europë një rëndësi të veçantë merr Deklarata franceze e të drejtave të qytetarit e 1789. Në Francë, nga fundi i shekullit të XVIII shoqëria ishte e ndarë në tre shtresa: fisnikëria, kleri, dhe shtresa e tretë. Vetëm ky i fundit paguante taksat pa qenë i përfaqësuar siç duhet. Pasojë e paevitueshme e kësaj situatë ishte dhe diferenca e thellë midis realitetit social, institucioneve dhe pushtetit. Më 17 qershor 1789 përfaqësuesit e shtresës së tretë mbledhen në asamble kombëtare si përfaqësues të gjithë popullit francez. U elaborua kështu *Deklarata e të drejtave të njeriut dhe qytetarit*, e cila u publikua më 11 korrik, tre ditë para marrjes së Bastijës. Deklarat u adoptua nga mbreti më 26 gusht 1789.

Të drejtat natyrore janë të listuara në art. 2 të Deklaratës dhe marrin inspirim nga kristianizmi dhe filozofia iluministe: liria dhe siguria fizike, liria e opinionit, liria ndërgjegjës, liria e mendimit dhe e shtypit, e drejta e pronës, parimi i barazisë para ligjit dhe para sistemit fiskal., Barazia e aksesit në administratën publike etj. Disa parime të tjera tepër aktuale edhe sot ishin: rezistenca ndaj shtypjes, prezumimi pafajsisë, përgjegjësia e funksionarëve publikë, kufizimi i pronës private vetëm për motive publike.

Pas shpalljes së deklaratave të mësipërme u fillua të përballohej çështja e skllavërisë, e përhapur gjërësisht në shumë shtete evropiane dhe sigurisht në të gjitha kolonitë amerikane. Skllavëria ishte në kontrast të hapur me parimin e barazisë të të gjithë njerëzve, të drejtën për liri, dhe ndalimin e punës së detyruar. Eliminimi i skllavërisë kishte filluar në disa koloni, kurse në Europë u adoptua për herë të parë nga Danimarka në 1792 dhe më pas Franca në 1794. Vendi i parë musliman që shfuqizoi skllavërinë ishte Tunizia në 1846. Shtetet e Bashkuara të Amerikës shfuqizimi i skllavërisë u realizua në 1865 (amendamenti 13). Në nivel evropian vendimi për eliminimin e skllavërisë u adoptua në Kongresin e Vienës në 1848 kurse në nivel ndërkombëtar ishte Lidhja e Kombeve ajo që adoptoi Konventën mbi shfuqizimin e skllavërisë në 1926 (OKB adoptoi konventën shtesë në 1956), dhe më pas edhe Organizata ndërkombëtare e punës adoptoi dy konventa në 1930 dhe 1953 që e ndalonin atë.

Afirmimi i të drejtave të njeriut gjen hapësirë dhe në kushtetutat e shteteve më të rinj. Kështu, në SHBA edhe pse Kushtetuta e 1778 nuk përmbante dispozita që i referoheshin të drejtave të njeriut, u adoptuan në 1791 10 amendamente që garantonin të drejta si liria e shprehjes, liria e fesë, liria e shtypit, e drejta për të mbajtur armë, paprekshmëria e banesës, të drejtat e individëve gjatë proceseve gjyqësore, civile dhe penale. Më vonë, u adoptuan dhe amendamenti 15 mbi të drejtën e njerëzve me ngjyrë për të votuar dhe amendamenti 19 që u garanton këtë të drejtë edhe grave, respektivisht në 1870 dhe 1920.

Në mbretërinë Belge, Kushtetuta e 1831 merr inspirim nga Revolucioni Francez dhe monarkia parlamentare angleze. Përmbante dhe ajo disa dispozita në mbrojtje të të drejtave të individëve.

Kushtetuta gjermane e Weimarit është gjithashtu e rëndësishme sepse jo vetëm përsëriti të drejtat civile e politike por zhvilloi dhe të drejtat sociale dhe ekonomike.

Sidoqoftë faza revolucionare e të drejtave të njeriut është ajo që filloi gjatë luftës së II botërore me diskutimin e Presidentit F.D. Roosvelt më 6 janar 1941 (para impenjimit të SHBA-ve në luftë). Roosvelt rreshtoi 4 liri që ai i gjykonte si të domosdoshme: Liria e fjalës dhe e shprehjes, liria e fesë, liria për të ikur nga mizeria dhe varfëria, dhe liria për të ikur nga frika (kjo e fundit i referohet të drejtës për të patur siguri). Këto formulime do të përmbliidhen në Kartën e Atlantikut të 19 gusht 1941, e cila përmbante parimet që do të udhëhiqnin rendin e ri botëror që do të formohej: dënimi i çdo aneksimi territorial, parimi i vetëvendosjes të popujve, bashkëpunimi ndërkombëtar, liria e tregtisë dhe liria e deteve, dënimi i përdorimit të forcës dhe zvogëlimi i armatimeve. Një hap tjetër i rëndësishëm është dhe Konferenca e Dumbarton Oaks e tetor 1944 gjatë të cilës Roosvelt afermonte që *“njohja e dinjitetit të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore, të drejtave të tyre të barabarta dhe të patjetërsueshme, përbën bazën e lirisë, drejtësisë dhe paqes”*. Projekti për ndërtimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara bazohet pikërisht në këtë njohje, gjë që do të garantonte zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare ekonomike dhe sociale dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ky objektivi gjendet dhe në Preambulin e Statutit të OKB-së: *“me qëllim ruajtjen e paqes...zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis kombeve të bazuar mbi respektimin e parimit të barazisë dhe vetëvendosjes së popujve...”*.

Në fund të këtij ekskursusi të shpejtë hapës, për të përmbledhur, mund të identifikojmë 4 fazat e zhvillimit të të drejtave të njeriut:

Në fazën e parë, atë të prehistorisë të së drejtës, mbrojtja është e limituar në disa të drejta të tipit natyror, si jeta dhe integriteti fizik, dhe vetëm në sferën e marrëdhënieve ndërpersonale. Domethënë akoma nuk është instauruar asnjë lloj formë raporti midis individëve dhe pushtetit egzistues.

Në fazën e dytë, që fillon në mesjetë, të drejtat e njeriut vijnë si pasojë e një pakti midis sovranit dhe individëve, ku të drejtat e njeriut shërbejnë si kufizuese të pushtetit absolut të sovranit. Gjatë fazës së tretë, atë që përkon me krijim e shteteve moderne, të drejtat e njeriut marrin karakter pozitiv, domethënë bëhen pjesë e ligjeve të shtetit, por sidoqoftë janë të kufizuara brenda për brenda territorit të këtyre shteteve.

Faza e katërt karakterizohet nga ndërkombëtarizimit të të drejtave të njeriut dhe nga marrja e një rëndësie gjithmonë e më të madhe të dy të drejtave që shpeshherë në të shkuarën injoroheshin: barazia dhe ndalimi diskriminimit.

II – TË DREJTAT E NJERIUT NË RENDIN NDËRKOMBËTAR TË SOTËM

Në arenën ndërkombëtare të pas luftës së II botërore u fillua të diskutohej gjërësisht për pozitivizim e të drejtave të njeriut, dhe në konceptin e të drejtës pozitive, Deklarata Universale e të drejtave të njeriut përbën padyshim një burim të dorës së parë (bashkë me Paktet e 1966 dhe Konventat e etjera të promovuara nga OKB-ja. Ky dokument u pasua me vonë nga disa dokumente të tjerë rajonale, si konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, Konventa interamerikane, Karta afrikane.

1. Aksioni i Kombeve të Bashkuara: Deklarata Universale e të drejtave të njeriut

Gjatë konferencës së San Francisco, përgjatë të cilës u ndërtua Statuti i Kombeve të bashkuara, presidenti Truman parapriu krijimin e Deklaratës Universale: *Ky tekst do të bëjë pjesë në jetën ndërkombëtare ekzaktesisht ashtu sic Deklarata jonë e të drejtave është pjesë integrale e Kushtetutës sonë.* Edhe pse deklarata nuk u përfshi në Statutin e OKB-së, gjithë teksti i këtij të fundit është i inspiruar drejt respektit të të drejtave të njeriut. Në fakt që në Preambul thuhet: *Ne popujt e Kombeve të Bashkuara, të vendosur... për të shpallur edhe njëherë besimin tonë në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe në vlerën e personit njerëzor, në barazinë e të drejtave të burrave dhe të grave ... kemi vendosur të bashkojmë forcat tona për realizimin e këtyre qëllimeve.* Gjithashtu, të drejtat e njeriut zënë vend dhe në dispozita të tjera të Statutit, si art 1, art 13, art 52, art 55, art 68, art 76, etj.

Që me hyrjen në fuqi të Statutit të OKB-së në 1946, doktrina juridike ishte e ndarë në lidhje me çështjen nëse dispozitat statutoe mbi të drejtat e njeriut përbënin ose jo detyrime juridike. Sipas disave e vetmja vlerë juridike e këtyre dispozitave konsiston në sanksionimin e fakultetit të organeve të OKB-së për të promovuar respektimin e të drejtave të njeriut nëpërmjet rekomandimeve, rezolutave, apo akteve të tjera të papajisura me forcën juridike të nevojshme për të ndërhyrë në punët e brendshme të shteteve në çështjet e të drejtave të njeriut. Disa të tjerë i atribuojnë këtyre dispozitave vetëm një vlerë programatike, me tepër një detyrim për të bashkëpunuar se sa një detyrim për të respektuar të drejtat e njeriut (Hans Kelsen shprehej se Statuti nuk imponon një detyrim të saktë për të respektuar të drejtat e njeriut të shprehura në preambulin e Statutit).

Një mendim të kundërt kishin Lauterpacht e Jessup: Shtetet kanë detyrimin kontraktuar për të arritur qëllimet e Statutit, midis të cilëve edhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Quinci Wright shkon edhe me tej. Sipas tij, ndërsa art. 55 i Statutit vendos një detyrim kolektiv për të gjithë shtetet anëtare të OKB-së për të promovuar respektin e të drejtave të njeriut, art. 56 përbën një detyrim për të ndërmarrë aksione individuale dhe kolektive për arritjen e respektit universal të të drejtave të njeriut.

Pavarësisht këtij debati, Deklarata Universale u adoptua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948 dhe nuk ka karakter detyrues, gjë e cila reflektohet dhe në mënyrën se si janë formuluar artikujt e saj. Deklarata nis nga presupozimi që të gjithë qeniet njerëzore janë të pajisura me arsye dhe ndërgjegje, lirinë të lirë dhe të barabrtë, dhe për këtë arsye duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta. Çdo hipotezë diskriminimi duhet të përjashtohet automatikisht. Sidoqoftë kjo nuk do të thotë që duhet të përjashtohen edhe ato diferencime të ligjshme të pranuar bashkarisht për tu përballur me situata të ndryshme, por vetëm diferencimet e paligjshme, që zakonisht ne i tregojme me termin

diskriminim. Të drejtat e tjera që përmban deklarata kanë të bëjnë me integritetin fizik, liritë personale, jetën private, të drejtën e qytetarisë, të drejtën e pronësisë, të drejtat gjatë procesit gjyqësor, të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, dhe se fundmi detyrimet që individit ka kundrejt komunitetit.

2. Deklarata Universale në sistemin e burimeve të së drejtës ndërkombëtare

Normat që disiplinojnë të drejtën ndërkombëtare burojnë ekskluzivisht nga keto tre burime (të renditur hierarkisht)

1. E drejta zakonore/konsueudinare
2. Aktet apo Marrëveshjet ndërmjet shteteve
3. Vendimet e enteve të krijuara nga Marrëveshjet e pikës 2.

Bëjnë pjesë të drejta zakonore të gjitha normat e pashkruara të të drejtës ndërkombëtare. Domethënë të gjithë ato norma që nuk bëjnë pjesë në të drejtën pozitive por që janë të detyrueshme për shtetet.

E drejta zakonore është e përbërë nga dy elementë:

- Elementi objektiv (diuturnitas ose praktika): përsëritja konstante dhe uniforme të një sjelljeje në koh.
- Elementi subjektiv (Opinio juris): bindja se ajo lloj sjelljeje është e detyrueshme.

Afirmimi i të drejtave të njeriut në Deklaratën Univerasale nuk është më një ideal për tu arritur por përfaqëson pikënisjen për krijimin e një sistemi juridik universal dhe pozitiv të të drejtave të njeriut: universal në kuptimin që destinatarë të këtyre të drejtave janë të gjithë individet, pa asnjë dallim; dhe pozitiv në kuptimin që vendosen bazat për mbrojtje efektive të të drejtave dhe jo thjesht një afirmim të tyre.

Deklarata nga pikëpamja e pastër juridike është një dokument jo detyrues dhe ky fakt u diskutua që në mbledhjet e komisionit të OKB-së që u mor me hartimin e saj. Që atëherë u tha që Deklarata nuk do të kishte veçse një “vlerë morale”. Por sidoqoftë shume të deleguar nënvizuan faktin që Deklarata ka një vlerë reale sepse tregon në mënyrë të qartë se cilat janë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, respektimi i të cilave duhet të promovohet sipas angazhimeve që shtetet kanë ndërmarrë duke firmosur Statutin e OKB-së. Duke firmosur statutin këto shtete kanë dashur me mirëbesim ti konformohen parimeve të shprehura në të, midis të cilëve dhe promovimi e respektimi i të drejtave të njeriut. Gjatë punimeve të komisionit hartues u tha gjithashtu që çdo shkelje e një prej të drejtave të sanksionuara në Deklaratë përbën një shkelje të parimeve të Statutit. Pra, Deklarata nuk është vetëm një deklaratë teorike dhe asnjë shtet nuk mund të shkelë parimet e shprehura në të pa shkelur në këtë mënyrë parimet e Statutit. Shtetet anëtare të OKB-së janë angazhuar solemnisht, nëpërmjet Statutit, të promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe për herë të parë këta të drejta dhe liri janë të saktësuara në detaj. Për këtë arsye çdo shtet është në detyrë të angazhimeve të tij dhe çdo individ mund të veprojë kundër shteteve që nuk respektojnë këtë angazhim.

Nga pikëpamja e ngushtë juridike, rezolutat e OKB-së, si ajo me anë të të cilës u adoptua Deklarata, nuk mund të konsiderohen si të detyrueshme për shtetet anëtare, domethënë që nuk janë të detyrueshme ashtu sic janë traktatet ndërkombëtare. Sidoqoftë, duke konsideruar solemnitetin me anë të cilës u adoptua Deklarata, mund të pranojmë që organi që e adoptoi ka manifestuar shpresën që shtetet e OKB-së ta respektojnë atë. Për pasojë, duke parë që kjo shpresë është e justifikuar nga praktika e

deritanishme e komunitetit ndërkombëtar, Deklarata mund të konsiderohet si një akt konsuetudinar që sanksionon rregulla të detyrueshme për shtetet. Praktika e OKB-së dhe të anëtarëve të saj duket sikur është e orientuar në këtë drejtim.

Kështu Asambleja e OKB-së ka përdorur në raste të shumta Deklaratën si kod apo model sjelljeje dhe është bazuar në tekstin e saj për ti drejtuar rekomandime shteteve në mënyrë që të ndërmarrin masa specifike për respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Psh, që në 1949, me rezolutën 324, Asambleja vendoste të deklaronte që të gjitha diskriminimet të bazuara në racë, gjuhë ... midis popujve janë të papërputhshme me parimet e Statutit dhe të Deklaratës Universale. Në raste të tjera Asambleja ka përdorur përmbajtjen e Deklaratës për të përcaktuar shkeljet e kryera nga disa shtete si dhe aksionet e ndërmarra nga OKB-ja për këtë arsye (sidomos kundër shkelejeve të kryera nga disa shtete afrikane. Në rezolutën 2144 të 1966 Asambleja shprehej *“e bindur për shkelje të rënda të të drejtave themelore të sanksionuara në Deklaratë nga ana e disa shteteve”* dhe ben thirrje për *“dyfishimin e punës për të favorizuar respektimin e plotë të të drejtave të njeriut të sanksionuara në Deklaratë”*.

Edhe Këshilli i sigurisë i OKB-së ka përdorur në disa raste Deklaratën për aksionet e tij. Psh në rezolutën 182 të 1963 Këshilli luste qeverinë e Afrikës së Jugut për ti dhënë fund masave diskriminuese dhe represive që shkelnin Deklaratën.

Së fundmi, edhe Këshilli ekonomik dhe social ka përdorur Deklaratën si parametër për ti dërguar rekomandime qeverive që të ndërmarrin masat e nevojshme për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit në sektorin ekonomik dhe social.

Pavarësisht përpleksiteteve mbi vlerën juridike të deklaratës, ky akt është përdor shpeshherë për të akuzuar shtetet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe, bashkë me sa u tha më sipër, dëshmon që OKB-ja i atribuon një peshë gjithmonë e me të madhe tezës sipas të cilës Deklarata ka krijuar në ngarkim të shteteve detyrime efektive, mospërmbushja e të cilave mund të jetë objekt i një dënimi të ashpër nga OKB-ja. Në rezolutën 1904 të 1963 Asambleja shpalli me unanimitet që *“të gjithë shtetet duhet të zbatojnë besnikërisht dhe në mënyrë konstante dispozitat e Kartës së OKB-së, Deklaratën Universale...”*.

Nga sa u tha më sipër mund të konkludojmë që dyshimet mbi natyrën dhe karakterin juridik të Deklaratës, dhe të dispozitavë që ajo përmban, janë tashmë të tejkaluara nga praktika konstante dhe koherente e OKB-së e cila i ka atribuar Deklaratës një vlerë të ngjashme me atë të Statutit të organizatës.

Jurisprudenca e Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë dhe pozicioni i marrë nga disa gjykatës të kësaj gjykate, na lejojnë të kryejmë një vlerësim të ri të kuptimit dhe të përmbajtjes së Deklaratës.

Gjykata ndërkombëtare e drejtësisë është organi gjyqësor të cilit shtetet e OKB-së i kanë besuar detyrën për të zgjidhur mosmarreveshjet midis tyre dhe për tu shprehur për cdo ceshtje të drejtës nderkombetare. Nepermjet jurisprudences së saj kjo gjykate ka konsoliduar zhvillimin e marrëdhënieve nderkombetare dhe të drejtës nderkombetare. Ajo mbetet organi më i rëndësishëm për zhvillimin e të drejtës nderkombetare. Për sa i përket ceshtjes të drejtave të njeriut, në praktiken e Gjykatës nderkombetare të drejtësisë është përhapur gjerësisht tendenca për të shtrirë aplikimin e konventave që kodifikojnë të drejtat e njeriut edhe në shtetet që nuk janë pale të këtyre konventave, duke ankoruar të drejtat e njeriut me të drejtën zakonore. Në fakt, sipas Gjykatës, parimet e përgjithshme për mbrojtjen

e te drejtave te njeriut te shprehura ne Statutin e OKB-se dhe Deklaraten Universale, te cilat jane perkthyer ne te drejte pozitive me adoptimin e nje numri te konsiderueshem marreveshesh, nepermjet praktikese se shteteve dhe *opinio juris* jane inkorporuar ne te drejten nderkombetare te pergjithshme, dhe domethene jane shtrire ne te gjithe komunitetin nderkombetar. Duke u kthyer ne te drejte zakonore ata tashme perbejne detyrime *erga omnes*, te detyrueshme per te gjithe shtetet e komunitetit nderkombetar.

Sipas gjykates gjithashtu, konsensusi universal i manifestuar nga shtetet ne aktet e OKB-se qe kodifikojne disa te drejta, apo ne rezolutat e OKB-se mbi parimet e pergjithshme te te drejtave te njeriut, perben proven *opinio juris*, domethene bindjes se kjo sjellje eshte e detyrueshme me ligj.

Sic eshte thene dhe me siper, afirmimet e para universale mbi te drejtat e njeriut te Statutit te OKB-se dhe Deklarates Universale kane ngritur dyshime interpretuese per sa i perket fuqise detyruese apo thjesht programatike te tyre. Jurisprudenca e Gjykates ka kontribuar thelbesisht ne nje interpretim progresiv qe i konsideron te drejtat e njeriut fillimisht si detyrime *erga omnes* te detyrueshme per shtetet pavaresisht pjesemarrjes se tyre ne nje konvente te caktuar, dhe me pas si norma *jus cogens*.

Ne ceshtjen Namibia (1966) gjendet njohja e pare e rendesise qe normat mbi te drejtat e njeriut kane ne sistemin e Kombeve te Bashkuara, si norma qe mbrojne interesin e pergjithshem te komunitetit nderkombetar. Ne kete rast Gjykata ka theksuar se parimet e pergjithshme te se drejtes nderkombetare, te perbashketa per kombet e civilizuar, perfshijne te drejtat e njeriut si te drejta te patjetersueshme te personit, te cilat nuk varen nga vullneti i shtetit per ti njohur ato: parimi i mbrojtjes universale te te drejtave te njeriut rjedh nga esenca e dinjitetit te njeriut si qenie njerezore, qe per definicion eshte i njejte, universal, dhe nuk njeh diskriminim. Egzistenca e te drejtave te njeriut nuk varet nga vullneti i shtetit, qe shprehet me ane te ligjit sepse shteti nuk ka pushtetin per te krijuar te drejta njerezore nepermjet ligjit apo nepermjet nje konvente, por ka vetem kapacitetin te displinoje egzistence e tyre dhe te siguroje mbrojtjen. Domethene te drejtat e njeriut egzistojne pavaresisht egzistences se normave juridike qe i permbajne keto te drejta.

Ne ceshtjen Barcelona Traction (1970) Gjykata u shpreh mbi natyren e detyrimeve te marra nga shtetet ne kuader te te drejtave te njeriut duke nenvizuar diferencat me detyrimet e tjera te se drejtes nderkombetare. Duke u nisur nga detyrimi i nje shteti per te mbrojtur te huajt te pranuar ne territorin e tij, Gjykata afermon detyrimin *erga omnes*: nga momenti qe nje shtet pranon nga komuniteti nderkombetar detyrimin per te mbrojtur te drejtat e njeriut, atehere komuniteti nderkombetar fiton te drejten per te kerkuar respektimin e ketij detyrimi.